ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **AGJENCIA QENDRORE E PROKURIMIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr[1] i prokurimit	**UA/2016-23-9009-2-1-1**
Nr i brendshëm	**AQP-AK-23-051-211**

Sa i përket tenderit për: **Krijimi i sistemit elektronik të proceseve për nevojat e Komisionit të Pavarur për Media / E-KPM-ja**

ANKESË

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Quantix L.L.C
(Shëno emrin e plote te kompanisë suaj)

Rruga Musa Tolaj , Nartel Center Lam B , Kati 12.
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

+38344876143
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

Betim Drenica
(Emri i plote i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

office66@thequantix.com
(Adresa elektronike)

08.12.2023
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

Limited liability company Quantix L.L.C Prishtina

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

[1] Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë: 04.09.2023 Data e hapjes së ofertave: 02.10.2023 Njoftimi mbi vendimin e AK-së:21.11.2023 Kërkesa për rishqyrtim e dt:27.11.2023 Vendimi për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim:30.11.2023

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒ **Jo** ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 10 i LPP-së
Neni 11 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së.

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt. 27.11.2023 përmes e-prokurimit jemi njoftuar me njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku është rekomanduar për kontratë grupin e OE Data Prognet Shpk me çmim prej118,000.00€ ndërsa ne jemi shpallur si tenderues i pasuksesshëm.

Ne kemi kërkuar qasje në dokumentacion të OE të rekomanduar për kontratë mirëpo nuk na është lejuar qasje plotë, prandaj autoriteti kontraktues nuk ka respektuar nenin 10 të LPP-së e po ashtu nuk ka përgatitur versionin e pastruar sipas nenit 11 të LPP-së, prandaj këto shkelje duhet korrigjuar.
Arsyetimi i AK-së se OE kanë plotësuar aneksin 3 Kërkesa për sekret afarist është arsyetim i paqëndrueshëm sepse autoriteti kontraktues mundet që sipas paragrafit 4 të nenit 11 të përgatit versionin e pastruar, por që një veprim i tillë nuk është ndërmarr nga autoriteti kontraktues.

Grupi i OE të rekomanduar për kontratë ka deklaruar si sekret afarist të gjithë dosjen e tenderit -dokumentet e dorëzuara. Ne nuk kemi pasur mundësi të qasjes në dosje, andaj në mungesë të shikimit të dokumentacionit ne duhet të ngritim pretendime me dyshime, andaj dyshojmë se i njëjti
Operatori Ekonomik DataProgNet SH.P.K është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:

Nuk na është lejuar të shohim listën e stafit, prandaj dyshojmë se ky OE nuk permbush kërkesën në lidhje me përvojën e stafit kërkuar sipas dosjes se tenderit.

Nuk na është lejuar të shohim dosjen e stafit te angazhuar, referenca, diploma, certifikata, apo kontrata, prandaj dyshojmë se stafi i angazhuar dhe dëshmitë e ofruara nga ky OE nuk janë sipas dosjes se tenderit. Po ashtu dyshojmë se edhe mungon ndonjë profil i caktuar.

Nuk na është lejuar të shohim dosjen e aktivitetit financiar përkatësisht qarkullimit te kompanisë, prandaj dyshojmë se kompania mund te mos ketë referencat e duhura sipas kërkesës.

Nuk na është lejuar të shohim zgjedhjen teknike për aplikacionin, prandaj dyshojmë se edhe nuk e ka fare. PO ashtu nuk shihet se si subjekti planifikon te dëshmoj zgjedhjen teknike me theks te veçantë se si do demonstroj ne 90% njohjen e gjuhës shqipe.

Sqarimet janë kërkuar në mënyrë kundërligjore në lidhje me deklaratën për mirëmbajtje, sepse ka qenë e qartë mospërputhja e ofrimit të periudhës së mirëmbajtjës.
Po ashtu është favorizuar OE i rekomanduar për kontratë edhe sa i përket platformës kur janë kërkuare sqarime, sepse me sqarime secili OE pranon se posedon platformë testuese. Ky OE është dashur të eliminohet pa kërkuar sqarime fare, prandaj në këtë rast neni 59.2 dhe 72 është përdor në mënyrë favorizuese në raport me OE e rekomanduar për kontratë.

Të gjitha këto dyshime tonë, kërkojmë që ti verifikoni dhe të analizoni edhe njëherë dosje e OE të rekomanduar për kontratë në të kundërtën ne jemi ët detyruar ti vazhdojmë procedurat ankimit edhe për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së.

Neve nuk na është lejuar qasja e plotë në dokumentet e OE të lartcekur, përkatësisht në dokumentet si: Qarkullimet bankare, stafi i kompanisë, projektet e realizuara, planin dinamik dhe propozimin teknik.

Pra ne dyshojmë se OE i lartcekur është i papërgjegjshëm, pasi që nuk i ka përmbushur të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit përkatësisht kërkesat për kapacitetin ekonomik dhe financiar, kapacitetin teknik dhe profesional dhe gjithashtu edhe specifikimet teknike.

Edhe **OE "PBC SHPK"** ka plotësuar aneksin 3 Kërkesa për sekret afarist, prandaj në mungesë të shikimit të dokumentacionit të këtij OE duhet të ngritim pretendime me dyshime.
Konsiderojmë se ky OE është i papërgjegjshëm me arsyet si në vijim:
Lista e stafit nuk përmbush kërkesën e dosjes së tenderit dhe stafi i ofruar nuk ka përvojën e kërkuara sipas dosjes se tenderit.
Stafi i angazhuar nuk kanë ofruar dëshmi për referenca, diploma, certifikata, apo kontrata, prandaj stafi nuk përmbush kriteret sipas dosjes se tenderit por dyshojmë se mungon edhe ndonjë profil i caktuar.
Dosja e aktivitetit financiar te kompanisë nuk është sipas kërkesës së dosjes së tenderit. Dyshojmë se kompania nuk ka referencat e duhura sipas kërkesës.

Nuk kemi pasur qasje në zgjedhjen teknike për aplikacionin, prandaj dyshojmë se mungon apo nuk është adekuate. Nuk shihet se si subjekti planifikon te dëshmoj zgjedhjen teknike me theks te veçantë se si do demonstroj ne 90% njohjen e gjuhës shqipe.

OE TECH VISION SH.PK; EDUSOFT, është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka cekur AK-së:

Ju nuk keni plotësuar kërkesat siç është kërkuar në dosje te tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Tek Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 pika 3.2 Minimum një (1) arkitekt të sistemit – personi i rekomanduar për këtë pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.8 Minimum një (1) Testues Softueri - personi i rekomanduar për këtë pozitë me CV dhe dëshmitë e ofruara nuk e përmbushë kërkesën e cekur në dosje të tenderit, tek pika 3.6 Minimum një (1) ekonomist – edhe pse në CV i shkruan qe është i certifikuar si kontabilist me gjithë mangësitë e ofertës të cekura më lartë komisioni i vlerësimit nuk e ka parë të arsyeshme qe të kërkoj sqarime shtesë.

Prandaj bazuar në të dhënat gjetur dhe në bazë të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni **10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve citoj:**

CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

sipas komisionit te vlerësimit kjo ofertë konsiderohet si ofertë e papërgjegjshme.

OE "Protecht SHPK është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka cekur AK-së:

Ju nuk keni plotesuar siç duhet Formularin e Tenderit, gjithashtu nuk keni dorëzuar me ofertë Sigurimin e tenderit siç edhe është kërkuar ne dosje te tenderit dhe njoftim për kontratë.

Në bazë të UDHËZUES Nr. 001/2023 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni **10. Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve citoj:**

Formulari i tenderit nuk është plotësuar si duhet apo mungon	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	Kusht administrativ
Sigurimi i Tenderit mungon apo nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

OE Komtel Project&Engineering SHPK është i papërgjegjshëm ashtu siç e ka cek AK-së:

Ofetra juaj nuk i ka plotësuar kërkesat siç është kërkuar në dosje të tenderit dhe në njoftimin per kontratë.

Tek Kërkesat mbi mundësitë teknik edhe/ose profesionale 9.1 & 9.2 Kërkesa numër 3 pika 3.1 3.1 Një (1) Menaxher / udhëheqës të projektit i cili duhet të këtë të përfunduar fakultetin e Inxhinierisë kompjuterike, Kompjuterikë me telekomunikacion ose shkenca kompjuterike dhe i njëjti të ketë përvojë min. 5 vite në menaxhimin e projekteve të ngjashme (projekteve softuerike);

Ju nuk keni arritur qe ta plotësoni plotësisht këtë kërkesë pasi qe nuk keni dorëzuar vendimin mbi caktimin e menaxherit te projektit,
Dëshmitë për kërkesën nr.3 –

Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim:

Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.2 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për piken 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për piken 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga njëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e kontabilisteve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt.

Gjithashtu ju nuk i keni plotesuar në tërësi edhe Kërkesa numër 2

Operatori ekonomik duhet të dorëzoi listën e stafit kyç të cilët do ti angazhoi në këtë projekt.
Dëshmitë për kërkesën nr. 2

Lista e dorëzuar nga operatori ekonomik mbi stafin e angazhuar duhet ti ketë emrat e stafit dhe rolin /pozitën që do të angazhohen në këtë projekt. Lista duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur.

Lista e stafit e dërguar nga OE nuk është e nënshkruar as e vulosur.

Ju nuk i keni plotesuar në tërësi edhe pikat
Dëshmitë për kërkesën nr.3 –

Për stafin udhëheqës profesional OE duhet të ofroj dëshmi si në vijim:

Vendimin për caktimin e menaxherit të projektit, CV-të, Referencat mbi përvojën e kërkuar, Diploma (për pikat 3.2 dhe 3.3 ose Certifikata nga Microsoft, për piken 3.4 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata, për piken 3.6 pos diplomës duhet të ofrohet edhe Certifikata si kontabilist i certifikuar nga njëra nga shoqatat të akredituara për certifikimin e kontabilisteve), Kontratat e punës me punëdhënësin ose marrëveshjet mbi angazhimin për këtë projekt.

gjithashtu nënshkruesi i dokumenteve te ofertës nuk është një person i autorizuar nuk e ka të bashkangjitur autorizimin nga pronari dhe në ARBK nuk figuron tek personat e autorizuar . Duke qenë se ju jeni eliminuar për piken e cekur më lartë dhe meqenëse nuk keni qen oferta me çmimin me te lire komisioni i vlerësimit nuk e ka pa të arsyeshme te kërkoj sqarime shtesë.

Nga faktet dhe argumentet që u cekën në këtë kërkesë për rishqyrtim kuptohet që OE kanë bërë kërkesë për sekret afarist ndërsa neni 11 e obligon autoritetin kontraktues që të vendos se cilat dëshmi mund të konsiderohen sekret afarist, e jo ti merren si obligim kërkesat e OE që i gjithë dokumentacioni siç e cekëm më lartë të cilësohet si sekret afarist. Pra AK-ja me këtë veprim nuk i ka respektuar dispozitat e nenit 10 dhe 11 të LPP-së për qasje në dokumente dhe për përdorimin e versionit të pastruar të dokumenteve, duke i favorizuar OE të rekomanduar për kontratë dhe OE tjerë që e kanë plotësuar aneksin 3.

Gjithashtu duhet cekur fakti se në raportin e vlerësimit i cili na është dhënë gjatë qasjes në dokumente nuk figuron askund nënshkrimi i anëtarëve të komisionit vlerësues, andaj ky fakt na bën të dyshojmë që ky raport nuk është përgatitur nga persona profesional për këtë fushë të prokurimit.

Me dt.30.11.2023 ne kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-se sa i përket kërkesës për rishqyrtim ku e njëjta e ka refuzuar si të pa bazuar.
AK-ja ne arsyetimin e saj nuk ka dhënë asnjë përgjigje konkrete si dhe asnjë arsyetim te bazuar se njoftimi mbi vendimin e AK-së ka qenë i drejtë dhe në pajtueshmëri me dispozitat ligjore të LPP-së.

Në kërkesë për rishqyrtim siç e kemi cekur edhe më lartë në ankesë kemi parashtruar pretendimet tona ankimore duke u bazuar në dyshime, për faktin se autoriteti kontraktues nuk na ka lejuar qasje të plotë në dokumentet e OE të rekomanduar për kontratë, me arsyetimin se i njëjti i ka deklaruar si sekret afarist shumicën e dokumenteve të tij.

AK-ja në vendimin për refuzim nuk ka dhënë asnjë arsyetim konkret sa i përket pretendimeve tona ankimore, mirëpo vetëm e ka cekur se kinse i ka respektuar dispozitat e neneve të kontestuara nga ne.
Në lidhje me pretendimin tonë ankimor për shkelje të nenit 10 dhe 11 të LPP-së, e njëjta e ka cekur se ka bërë versionin e pastruar të dokumenteve dhe konstatimet se cilat dokumente janë sekret afarist e cilat jo, i ka bazuar në nenin 11.4 të LPP-së.
AK-ja nuk ka vepruar në këtë mënyrë siç ka pretenduar, pasi që në këtë rast nuk mund të deklarohen si sekret afarist dokumentet në lidhje me kontratat, stafin, përvojën e punës apo dokumentet tjera, pasi që të njëjtat nuk janë dokumente që duhet të konsiderohen konfidenciale, sepse nëse zbulohen këto dëshmi nuk dëmtohet fare kompania fituese.
Njëkohësisht OE i rekomanduar për kontratë nuk ka dhënë asnjë arsyetim të bazuar dhe të dëshmuar siç kërkohet në paragrafin 3.3 të nenit 11 të LPP-së se si dhe përse mund ti shkaktojë dëm material zbulimi apo qasja në dokumentet që i ka konsideruar sekret afarist.

Autoriteti kontraktues e ka cekur se është bërë versioni i pastruar i dokumenteve dhe se na janë dhënë dokumentet, me përjashtim të dokumenteve që kanë të bëjnë me nenin 68 dhe 69 të LPP-së, sipas kërkesës së OE të rekomanduar për kontratë, mirëpo neve nuk na janë ofruar dokumentet që e përbëjnë pjesën kryesore të tenderit dhe prej të cilave varet përgjegjshmëria e operatorëve ekonomik.
Në lidhje me arsyetimin e lartcekur ju sqarojmë se edhe përkundër faktit që OE kanë bërë kërkesë për sekret afarist, neni 11 e obligon autoritetin kontraktues që të vendos se cilat dëshmi mund të konsiderohen sekret afarist, e jo ti merr obligativisht kërkesat e OE që i gjithë dokumentacioni siç e cekëm më lartë të cilësohet si sekret afarist. Edhe pse AK-ja po e cek se kinse ka bërë versionin e pastruar, ne ju sqarojmë edhe një herë se nuk mund të konsiderohet i gjithë dokumentacioni në lidhje me kapacitetin teknik dhe profesional si sekret afarist dhe se nuk është përgatitur versioni i pastruar konform Rregullativës ligjore dhe konform praktikave më të mira ndërkombëtare.

Me këtë veprim AK-ja e ka favorizuar haptas OE e rekomanduar për kontratë dhe OE tjetër i cili është shpallur si tenderues i pasuksesshëm, pasi që i ka lejuar dhe faktikisht i ka pranuar pothuajse të gjithë dokumentacionin si sekret afarist.

Sa i përket pretendimit tonë ankimore në lidhje me propozimin teknik për projektin e prezantuar nga OE i rekomanduar për kontratë, AK-ja është munduar të arsyetohet duke e cekur se propozimi teknik nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit dhe si i tillë nuk ka qenë pjesë e vlerësimit edhe pse OE-të kanë ofruar një propozim të tillë.
Vet fakti që OE të cilët kanë ofertuar, e kanë prezantuar propozimin teknik, kuptohet qartë se arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa qëndrueshëm, sepse nëse nuk do të kërkohej propozimi teknik atëherë OE nuk do ta ofronin fare një propozim të tillë.

Sa i përket arsyetimit të AK-së, ku e njëjta e ka cekur se komisioni i vlerësimit të ofertave ka qenë i përbërë prej 3 anëtarëve ku dy prej tyre kanë qenë nga njësia e kërkesës KPM, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i AK-së për ne është i pa bazuar. Ne e kemi cekur qartë se raporti i komisionit vlerësues që na është prezantuar nga ana e AK-së, nuk ka asnjë nënshkrim nga ana e anëtarëve të komisionit, andaj kemi parashtruar pretendimin se i njëjti raport nuk është përgatitur nga zyrtar profesional. Në lidhje me këtë pretendim tonin ankimor AK-ja ka dhënë arsyetimin siç e cekëm më lartë, mirëpo duke mos na ofruar dëshmi të nënshkrimit të raportit, ne përveç se dyshojmë që i njëjti nuk është përgatitur nga zyrtar profesional, njëkohësisht dyshojmë që edhe vet anëtarët nuk janë pajtuar me rekomandimin për kontratë të OE që është rekomanduar për kontratë.
Andaj kërkojmë nga eksperti shqyrtues i OSHP-së dhe paneli shqyrtues të na e sqarojnë me fakte konkrete se anëtarët e komisionit kanë qenë persona kompetent për një vlerësim të tillë dhe se a është nënshkruar raporti i komisionit nga të gjithë anëtarët.

Autoriteti kontraktues në vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim i është referuar nenit 56.3 sa i përket pretendimeve tona ankimore kundrejt propozimit teknik të OE të rekomanduar për kontratë. Ky arsyetim i autoritetit kontraktues e tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë, pasi që mos përmbushja e specifikimeve teknike nuk mund dhe nuk duhet të arsyetohet në asnjë mënyrë.

Sa i përket sqarimeve që i janë kërkuar OE të rekomanduar për kontratë dhe të cilat sipas AK-së kanë qenë bindëse, ju sqarojmë se edhe ky arsyetim i të njëjtës është i pa bazuar dhe i paqëndrueshëm.
OE i rekomanduar për kontratë në përgjigjjet e tij në kërkesën për sqarime e tregon qartë papërgjegjshmërinë e tij, mirëpo që AK-ja nuk e ka marr parasysh fare këtë gjë, ku përmes

fakteve që po ju prezantojnë më poshtë po vërtetohen pretendimet tona ankimore se vlerësimi i ofertave nuk është bërë nga persona kompetent/profesional.

Tek përgjigja nr.2, OE i rekomanduar për kontratë ka dhënë sqarimin si në vijim:

- spaCy: SpaCy është një bibliotekë e njohjes natyrore e pasur dhe e specializuar për shumlë gjuhë, duke përfshirë edhe shqipen. Kjo bibliotekë ofron analizë morfologjike, analizë sintaksore, dhe shërbime tjera për trajtimin e tekstit në gjuhën shqipe.

Ky konstatim i OE të rekomanduar për kontratë është i paqëndrueshëm sepse spaCy nuk përdoret për njohjen e gjuhës siç pretendon OE i rekomanduar për kontratë, mirëpo përdoret për përdorime të modeleve gjuhësore, domethënë nuk përdoret për një space speech recognition

- NLTK (Natural Language Toolkit): NLTK është një bibliotekë e njohjes së gjuhës natyrore të zhvilluar në Python. Ajo ofron mjetet dhe burimet e nevojshme për analizën e tekstit shqip dhe për zhvillimin e aplikacioneve të ndryshme të bazuar në gjuhën natyrore

Gjithashtu edhe NLTK nuk përdoret për speech recognition, por përdoret për manipulime gjuhësore dhe si e tillë nuk e zgjidh problemin e speech recognition.

- Hugging Face Transformers: Hugging face ofron një koleksion të madh të modeleve të mësimit automatik të gjuhës natyrore të shqipes. Ky resurs është i dobishëm për të përdorur modele të gatshme për punë me tekst në gjuhën shqipe ose për të zhvilluar modele të personalizuara për detyra të veçanta

Po ashtu ju sqarojmë se edhe konstatimi i lartcekur i OE të rekomanduar për kontratë, nuk është i qëndrueshëm për faktin se Hugging Face Transformators është emri i kompanisë e cila ka të bëjë me menaxhimin e modeleve të inteligjencës artificiale por nuk është specifike për njohjen e gjuhës së folur dhe kthimin e saj në gjuhë të shkruar, siç është kërkuar në dosje të tenderit.

Pra duke u bazuar në faktet e lartcekura, kuptohet qartë se përgjigjjet e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë analizuar në tërësi nga ana e AK-së, mirëpo vetëm i janë marrë parasysh pa i analizuar fare dhe ky veprim i AK-së tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë.

Gjithashtu AK-ja në vendimin për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, e ka cekur se i ka kërkuar sqarime OE të rekomanduar për kontratë edhe në lidhje me çmimin me të cilin ka ofertuar, pasi që sipas nenit 41.3 të Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik tenderi i të njëjtit është jo normalisht i ulët, mirëpo që nuk na ka dhënë as këtë dokument sepse në përgjigjjen e OE ka pasur elemente të nenit 68 dhe 69 të LPP-së. Me vet faktin që OE i rekomanduar për kontratë nuk e ka deklaruar edhe përgjigjjen si sekret afarist, mirëpo vet AK-ja ka deklaruar se ka përmbajtur elemente të nenit 68 dhe 69 të LPP-së, ky arsyetim i të njëjtës po e tregon qartë favorizimin që po i bëhet OE të rekomanduar për kontratë nga ana e AK-së.

Autoriteti kontraktues nuk i ka shqyrtuar fare pretendimet tona në lidhje me OE "PBC SHPK", i cili është shpallur si tenderues i pasuksesshëm, ndërsa me këtë veprim edhe një herë po e tregon qartë diskriminimin që po i bën kompanisë tonë, si OE i vetëm i përgjegjshëm në këtë aktivitet të prokurimit.

Duke u bazuar në të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i pa qëndrueshëm dhe njëkohësisht i pa mbështetur në dispozita ligjore, mirëpo është vendim që favorizon OE të rekomanduar për kontratë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet qe u cekën më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse është rekomanduar për kontratë OE i cili nuk i ka plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes se tenderit dhe te njoftimit për kontratë dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës, e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët sipas neni 60 paragrafi 1.1 i LPP-së.

Në këtë tender vetëm ne jemi OE i përgjegjshëm, prandaj është dashur të shpallemi fitues. Gjithashtu AK-ja nuk e ka respektuar edhe nenin 7 të LPP-së, sepse ne i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë dhe nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente"*. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që *"Gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo AK-ja nuk i wshtw përmbajtur as kësaj dispozite ligjore duke e rekomanduar për kontratë një OE të papërgjegjshëm.

Gjithashtu autoriteti kontraktues është dashur të kete në konsideratë edhe nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.
Në fund kërkojmë që të analizohet në tërësi oferta e OE të rekomanduar për kontratë se a i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë ose të detyrohet AK-së që të na jep qasje të plotë në ofertën e OE të rekomanduar për kontratë dhe të OE tjerë të cilat kanë deklaruar sekret afarist tërë ofertat e tyre.
Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE ***Quantix L.L.C.*** si e bazuar,
ANULOHET njoftimi mbi vendimin (B58) e AK-së, për dhënie të kontratës si dhe lënda te kthehet në
RIVLERËSIM,
DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.

b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".

c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.

d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*